

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 296, Datë 17.11.2025

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 276, DATË 13.12.2024
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “M.C ENERGJI GOJAN” SH.P.K., NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “GOJAN”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar;; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.11.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e për gatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 2871 prot., datë 14.11.2025, “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 276, datë 13.12.2024 “Mbi licencimin e shoqërisë “M.C ENERGJI GOJAN” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Gojan”,

Konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “M.C ENERGJI GOJAN” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 276, datë 13.12.2024, ka licencuar shoqërinë “M.C ENERGJI GOJAN” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Gojan”.
- Në pikën 2 të vendimit nr. 276/2024 përcaktohet se: “Shoqëria duhet të vendosë në punë hidrocentralin brenda datës 28.11.2025”.
- Gjithashtu në pikën 3 të këtij vendimi përcaktohet se: “Ky vendim është objekt rishikimi”.
- Sipas raportimeve periodike të ERE-s, mbi të dhënat e tregut të energjisë elektrike, konstatohet se HEC “Gojan” ka hyrë në prodhim në muajin shkurt 2025.

2. Analiza Ligjore dhe Vlerësimi

- Shoqëria ka hyrë në prodhim përpara afatit të përcaktuar në pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 276, datë 13.12.2024, duke përmbushur kushtin e vendosur. Për rrjedhojë, ky kusht konsiderohet i realizuar dhe duhet të shfuqizohet.
- Me shfuqizimin e kushtit në pikën 2 të vendimit 276/2025, duhet të shfuqizohet dhe pika 3 e vendimit të lartpërmendur e cila përcakton se ky vendim është objekt rishikimi në kuadër të plotësimit të kushtit të përcaktuar në pikën 2.

3. Nevoja për Ndryshimin e Vendimit

- Në mbështetje të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë, vlerësohet se pikat 2 dhe 3 të dispozitivit të vendimit të bordit të ERE-s nr. 276, datë 13.12.2024, duhet të shfuqizohen, pasi shoqëria “M.C ENERGJI GOJAN” sh.p.k. ka përmbushur kushtin përkatës dhe duhet të reflektohet situata aktuale e realizimit të projektit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pikat 2 dhe 3 të vendimit të ERE-s nr. 276, datë 13.12.2024, shfuqizohen.
2. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, të njoftojë shoqërinë “M.C ENERGJI GOJAN” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OST” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a., lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI